



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3150/9 prot.

Pogradec, më 28.08 2025

VENDIM

NR 17, DATË 28.08.2025

PËR

“MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATAVE TË QIRASË PËR AMBIENTE ARSIMORE NË BASHKINË POGRADEC PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, shkronjës "a", dhe "c", të nënpikës 1.2 të nenit 9, në pikën 12 të nenit 23, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 21, 22, nenit 28, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në nenin 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", vendimi nr. 659, datë 03.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021- 2026", në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec nr.90, datë 29.08.2024, si dhe mbështetur tek Relacionet shpjeguese të Qendrës Arsimore dhe Kërkesat e Administratorëve të Njësive Administrative,

**KËSHILLI I BASHKISË
VENDOSI:**

1. Miratimin e rinovimit të kontratave të qirasë për ambiente arsimore publike në Bashkinë Pogradec, të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e procesit mësimor për vitin shkollor 2025-2026.
2. Rinovimi i kontratave sipas pikës një të këtij vendimi, hyn në fuqi më datë 01.09.2025, që korrespondon me fillimin e Vitit të Ri shkollor 2025-2026 dhe do të zgjasë deri në dt. 01.07.2026.

3. Vlerat e kontratave dhe Kushtet e tjera të tyre mbeten të pandryshuara. Vlerat e qerasë mujore për secilën Njësi Administrative janë si më poshtë:

3.1 **Fshati Selcë e Poshtme Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec,** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si shkollë, me vlerë 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.

3.2 **Fshati Buzaishtë, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec:** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si kopsht me vlerë 6,000 (gjashtë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.

3.3 **Fshati Stropckë, Njësia Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec:** Rinovimin e kontratës së qirasë për ambientin që shërben si kopsht, me vlerë 8,000 (tetë mijë) lekë në muaj, për periudhën Shtator 2025 - Korrik 2026.

4. Mosrinovimi i kontratës së qirasë për ambientin që shërbente si shkollë (arsim fillor) në **fshatin Buzaishtë, Njësia Administrative Velçan** për periudhën Shtator 2024 - Korrik 2025, pasi nuk plotësohen kriteret minimale të vendosura nga MAS përsa i përket numrit minimal të regjistrimeve të nxënësve për vitin mësimor 2025-2026

5. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Qendra Arsimore pranë Bashkisë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

ZV/ KRYETARË E KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI

1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.08.2025

